

**LIGJ**  
**PËR NDRYSHIMIN E LIGJIT PËR AGJENCI TEKNIKE OPERATIVE**

**Neni 1**

Në Ligjin për Agjenci Teknike Operative (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë numër 71/18), neni 33 ndryshohet si vijon:

“Neni 33

Mjetet për rrogë, kompensime dhe shtesa të rrogës, për punë, avancim, modernizim dhe pajisje të ATO-s, si dhe për stimulimin e punonjësve në ATO, të parapara me planin financiar vjetor të ATO-s, sigurohen nga kompensimet e Agjencisë për Komunikime Elektronike të Republikës së Maqedonisë, sipas Ligjit për komunikime elektronike, në bazë të planit financiar të miratuar paraprakisht të Agjencisë Teknike Operative nga Komisioni për Mbikëqyrje të Zbatimit të Masave për Ndjekje të Komunikimeve i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë dhe nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.”.

**Neni 2**

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë”, e do të fillojë të zbatohet nga 1 marsi 2019.